

**ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM TË PROVIMIT TË
MATURËS NË GJIMNAZ, GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, QERSHOR 2015**

DETYRA 1. -1 pikë

**4. të tregojë në pikëpamjet e ndryshme për përzgjedhjen e shtatë
mrekullive të botës**

DETYRA 2. – Nxënësi/nxënësja merr 2 pikë nëse ka veçuar: një nga argumentet, p.sh: UNESCO nuk e ka mbështetur nismën e Veberit sepse gara nuk ka karakter universal **dhe ka dhënë shpjegimin përkatës, p.sh.:** e drejta e votimit u është pamundësuar atyre që nuk kanë pasur qasje në internet etj.

Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka dhënë vetëm argumentin përkatës pa dhënë ndonjë shpjegim

Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 3. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse *i lidh informacionet nga teksti se Piramidat e Mëdha në Giza janë të vetmet çudi botërore të botës së lashtë që ekzistojnë edhe sot*

Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 4. – 1 pikë

3. shekulli II p.e.s.

DETYRA 5. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse nga komentit i pjesëmarrësve nxjerr përfundimin se këto gara kanë qenë të dëshirueshme ose të rëndësishme sepse vendit të zgjedhur që ndodhej në listën e çudive apo mrekullive të botës së re i sjellë reputacion, popullaritet dhe përfitime ekonomike etj.

Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 6. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Mund të ketë domethënie simbolike, sepse numri shtatë gjendet edhe në ditën edhe në muajin edhe në vitin e shpalljes së fituesit të mrekullive të reja të botës (numri shtatë edhe te grekët e vjetër kishte domethënie magjike). Pranohen të gjitha përgjigjet e ngjashme ku nxënësi apo nxënësja*

tregon për lidhjen në mes të numrit shtatë në datë dhe numrit të mrekullive të botës.

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 7. – 1 pikë

4. të tregojë për lidhjen e mundshme në mes të kujtesës dhe muzikës

DETYRA 8. – 1 pikë

3. zvogëlon shtypjen e gjakut dhe relakson zemrën

DETYRA 9. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse është përgjigjur: ***Muzika me 60 goditje në një minutë rrit potencialin për mësim ose tregon në lidhjen në mes të ritmit/tempo së muzikës dhe ndikimit të saj në mësim***

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 10. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: ***Luajtja në instrumente dhe këndimi***

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 11. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: ***Ajnshtajni – gjeni duke falënderuar violinën dhe përgjigje të ngjashme të pranueshme që shfrytëzojnë faktet interesante, por jo edhe më të rëndësishmet nga teksti në mënyrë që të tërheqin vëmendjen e lexuesve***

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 12. – Nxënësi/nxënësja merr 2 pikë nëse ka dhënë sqarimin nën **A)** të domethënies frazeologjike – ***e jep me dorë dhe e merr me këmbë***: **Dikush**

të jep diçka me bujari dhe e merr me vështirësi të madhe (Kur një njeri s'është mirënjohës dhe s'ta kthen vetë huan a sendin që i ke dhënë) dhe nën B) ka shkruar një frazeologjizëm tjetër me domethënie të ngjashme që

nuk shpreh mirënjohjen, si p.sh.: ***Po i dhe krahun të merr kokën ose po i dhe gishtin të merr dorën***

Nxënësi/nxënësja merr **1 pikë** nëse ka ***dhënë përgjigjen e saktë ose nën A) ose nën B)***

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 13. – Nxënësi/nxënësja merr **2 pikë** nëse i ka gjetur **të katër** gabimet gjuhësore dhe drejtshkrimore nga fjalitë e dhëna dhe fjalitë e përmirësuar i ka shkruar mbi vija: ***Me komshiun je më shumë se me vëllain. Të gjendet për çdo gjë, po të mos jetë si ai që e jep me dorë dhe e merr me këmbë.***

Vërejtje: Pranohet edhe nëse nxënësi/nxënësja i ka përmirësuar gabimet gjuhësore dhe drejtshkrimore por nuk i ka përshtkruar fjalitë e përmirësuar mbi vendin e lënë bosh.

1 pikë – dy gabime të gjetura dhe të përmirësuar.

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 14. – Nxënësi/nxënësja merr **1 pikë** nëse ka shkruar: ***i largëti.***

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 15. – **1 pikë**

4. Rrymës letrare të Bejtexhinjve

DETYRA 16. – Nxënësi/nxënësja merr **1 pikë** nëse ka shkruar: ***Kënga e Gjergj Elez Alisë bën pjesë në këngët e ciklit të kreshnikëve, etj.***

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 17.- Nxënësi/nxënësja merr **1 pikë** nëse ka shkruar: ***Të qenët e kundërshtarit me një qenie përralore,etj.***

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 18. – **1 pikë**

2. për një dyluftim të rreptë

DETYRA 19. – 1 pikë

2. qe nandë vjet qi kam marrë rrugn' e vorrit

DETYRA 20. – 1 pikë

3. e përngjitur

DETYRA 21. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Në mënyrën habitore*

Nxënësi/ nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 22. – 1 pikë

2. mejdanin/çobanin

DETYRA 23. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Në fragmentin e zgjedhur gërshetohet dashuria dhe atdhedashuria.*

Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 24. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *atmosfera e lumturisë.*

Vërejtje: Pranohen edhe përgjigje të ngjashme të sakta.

Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 25. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Në vetën e parë*

Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 26. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Gjendjen e mundimshme shpirtërore*

Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 27. – Nxënësi/nxënësja merr 1 pikë nëse ka shkruar: *Kryejnë funksionin e kundrinës së zhdrejtë*

Nxënësi/nxënësja merr 0 pikë nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 28. – Nxënësi/nxënësja merr **1 pikë** nëse ka shkruar funksionin sintaksor ose morfologjik të fjalës:

Pjesa e nënvizuar është rrethanor qëllimi, apo emër me parafjalë.

Nxënësi/nxënësja merr **0 pikë** nëse nuk ka shkruar asgjë ose ka dhënë përgjigje të gabuar

DETYRA 29. – 1 pikë

1. rrokje të mbyllur

DETYRA 30. – Skema për vlerësimin e esesë

1. “RRUGËTIMI I GILGAMESHIT DHE HISTORIA E PËRMBYTJES SË MADHE”

Përmbajtja 15 pikë

Kërkesa 1.	Nxënësi/ ja: 1. tregon si lindi dëshira e Gilgameshit për pavdekësi (1 pikë) 2. tregon për vdekjen e shokut të tij më të mirë Enkiduit (1 pikë) 3. shkruan për udhëtimin e gjatë dhe të vështirë të Gilgameshit në kërkim të bimës së jetës (1 pikë) Gjithsej 3 pikë
Kërkesa 2.	Nxënësi/ ja: 1. shkruan për takimin e Gilgameshit me plakun Utnapishtimë (1 pikë) Gjithsej 1 pikë
Kërkesa 3.	Nxënësi/ ja: 1. shkruan për historinë e fshehtë që i tregon për Përmbytjen e Madhe (1 pikë) 2. tregon vendimin e perëndisë Beli që të shkaktojë Përmbytjen e madhe dhe të shfarosë njerëzimin (1 pikë) 3. shpreh qartë mendimin që ka për një akt të tillë mizor (1 pikë) 4. shkruan për hyjninë e thellësive Ea dhe veprën që bën ajo duke i treguar Utnapishtimës për përmbytjen (1 pikë) 5. tregon mendimin që ka për aktin heroik të hyjnisë Ea

	<p>(1 pikë)</p> <p>6. tregon se çfarë ka futur Utnapishtima në barkë (Çdo lloj fare të jetës)</p> <p>(1 pikë)</p> <p>7. shkruan për reagimin e Utnapishtimës kur sheh çdo gjë të shkatërruar (1 pikë)</p> <p>Gjithsej 7 pikë</p>
<p>Kërkesa 4.</p>	<p>Nxënësi/ ja:</p> <p>1. tregon për zemërimin e hyut Beli kur mëson për barkën e shpëtuar</p> <p>(1 pikë)</p> <p>2. shkruan për ndëshkimin dhe mësimin që i japin perënditë hyut Beli</p> <p>(1 pikë)</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>
<p>Kërkesa 5.</p>	<p>Nxënësi/ ja:</p> <p>1. tregon për mësimin moral që marrim nga ngjarja (1 pikë)</p> <p>2. shkruan se si duhet të gjykojmë, në mënyrë relative apo absolute. (Hyu Beli për shkak të disa mëkatarëve deshi të ndëshkojë gjithë njerëzimin dhe ky është një gjykim absolut e jo relativ) (1 pikë)</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>

Gjuha dhe forma e tekstit 10 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
→ origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale	→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi , përemrit i vet/ i tij , përdorimi i	→ lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve 2 pikë	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët) 2 pikë

<p>2 pikë</p>	<p>drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p>2 pikë</p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të</p>		
----------------------	--	--	--

	<p>cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>		
<p>→ përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta</p> <p>1 pikë</p>	<p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p>1 pikë</p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>1 pikë</p>	<p>→ lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në nivel të paragrafëve</p> <p>1 pikë</p>	<p>→ ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p>1 pikë</p>

	Gjithsej 2 pikë		
--	------------------------	--	--

2. SHOQËRIA DHE INDIVIDU NË PASQYRËN E PARAGJYKIMEVE

Përmbajtja – 15 pikë

Kërkesa 1.	<p>Nxënësi / ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon domethënien e nocionit të paragjyimit dhe tregon për mundësitë e përkufizimit të këtij nocioni në kontekstin më të gjerë të interpretimit dhe të kuptuarit (2 pikë) - jep sqarimin e njëanshëm të këtij nocioni pa kontekst të gjerë të interpretimit dhe të kuptuarit (1 pikë) <p>Gjithsej 2 pikë</p>
Kërkesa 2.	<p>Nxënësi / ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan përse të gjithë në disa situata shërbehemi me paragjykime <p>1 pikë</p>
Kërkesa 3.	<p>Nxënësi / ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përmend paragjykimet më të shpeshta të cilat formohen te individit nën ndikimin e edukatës familjare dhe autoritetit prindëror (1 pikë) - nëse jep një përgjigje më të hollësishme dhe më me stil (1 pikë) <p>Gjithsej 2 pikë</p>
Kërkesa 4.	<p>Nxënësi / ja tregon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për perceptimin negativ të disa komuniteteve të shkaktuara nga paragjykimet (1 pikë) - kush është objekt më i shpeshtë i paragjykimeve dhe diskriminimeve në rrethin e tij/e saj (1 pikë) <p>Gjithsej 2 pikë</p>
Kërkesa 5.	<p>Nxënësi / ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan si duken disa profesione në pasqyrën e paragjykimeve duke dhënë më shumë se një shembull (2 pikë) - nëse hollësisht përshkruan një profesion në pasqyrën e paragjykimeve (1 pikë) <p>Gjithsej 2 pikë</p>
Kërkesa 6.	<p>Nxënësi / ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - sqaron sa janë disa modele të mendimeve rigide të rrezikshme për shoqërinë (1 pikë) - sqaron sa janë disa modele të mendimeve rigide të rrezikshme për individin (1 pikë) - jep ndonjë shembull të pasojave ekstreme të paragjykimeve (1 pikë) - nëse jep një përgjigje më të hollësishme, më me stil dhe me përmbajtje (1 pikë) <p>Gjithsej 4 pikë</p>

Kërkesa 7.	Nxënësi / ja: - Shpreh mendimin e vet se në çfarë mënyre mund të ndryshohen ose të luftohen stereotipet (1 pikë) - nëse jep një përgjigje më të hollësishme, më me stil dhe me përmbajtje (1 pikë) Gjithsej 2 pikë
-----------------------------	--

Gjuha dhe forma e tekstit 10 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
→ origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale 2 pikë	→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi , përemrit i vet/ i tij , përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale 2 pikë → respektimi i normës drejtshkrimore	→ lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve 2 pikë	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët) 2 pikë

	<p>(shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p style="text-align: right;">2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>		
<p>→ përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p>	<p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p> <p>→ respektimi i</p>	<p>→ lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në nivel të paragrafëve</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p>	<p>→ ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p style="text-align: right;">1 pikë</p>

	<p>normës drejtshkimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>		
--	---	--	--

